

C.nr.171/2016

GJYKTA THEMELORE MITROVICE (ne objektin e deges se kesaj gjykate ne Vushtrri), gjyqtari Skender Shala, me qeshtjen juridike kontestimore te paditesit Fsh. Komuna e Mitrovides, kunder te paditures () per pagimin e pagave jubilarë dhe pages percjellse me rastin e shkuarjes ne pension, pas nbajtjes se shqyrtimit kryesore, te mbajtur me dt. 13.07.2017, bie kete:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET kerkesepadia e paditsit nga Fsh. Komuna e Mitrovides e ushtruar kunder te paditures (), per pagimin e pagave jubilarë dhe pages percjellse me rastin e shkuarjes ne pension, e **PA BAZUAR**.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

A r s y e t i m

Paditesi ka ushtruar padi ne kete gjykate kunder te paditures per pagimin pagave jubilarë dhe pagave percjellse me rastin e shkuarjes ne pension.

Paditesi ne seancen e shqyrtimit kryesor theksoi se Mbetem prane padise dhe kerkesepadise se parashtuar dhe me tutje shton se paditsi me rastin e pensionimit e kam pasur rrogen 478,00 euro . Une me daten 01.02.2016 iu kam drejtuar te paditures me kerkesen per pagimin e pagave me rastin e shkuarjes ne pension dhe pagave jubilarë. Me daten 08.03.2016 kam pranuar pergjegje nga e paditura se kerkesa ime eshte refuzuar.Andaj konsideroj se ne baze te nenit 43 dhe 44 te Kontrates kolektive me takojne pagat e cekura si ne kerkespadi.Ne fjalen e tije perfundimtare theksoi se mbetet ne teresi prane padise dhe kerkespadise si dhe thenjeve te cekura me larte.

Shpenzimet e procedures konstestimore nuk I kerkoj

Gjykata seancen e shqyrtimit kryesor e mbajti ne mungese te Perfaqesuesit te te paditures, conform nenit 423.4 te LPK.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vleresimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-se erdhe ne perfundim se duhet te vendosur si ne dispozitiv te keti Aktgjykimit.

Gjykata në procedurën e provave lexoi; Lexohet vendimi I dt. 28.01.2016 për njohje e se drejtes në pension baze – kontributiv leshuar nga udheheqesi I divizionit të skemave pensionale në Mitrovicë, Lexohet vendimi I dt. 28.01.2016 për njohje e se drejtes në pension baze – kontributiv leshuar nga udheheqesi I divizionit të skemave pensionale në Mitrovicë, pergjigja nga e paditura nr. dt. 04.02.2016.

Pas analizimit dhe cmuarjes së provave të cekura një nga një dhe të gjitha së bashku si dhe rezultateve të tërë procedurës, gjykata e vlerësoi se në mes të paleve procedurale nuk janë kontestuese këto fakte:

Se paditesi ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura në Mitrovicë, në vend pune profesor I ledes.

Se paditesit marrëdhënia e punës I është pushuar me arritjen e moshës së pleqërisë 65 vjeçare, për shkak të plotësimit të kushteve për pension të pleqërisë dhe se I njëjti e ka pasur pagën 478.00 €.

Keto janë fakte të provuara me prova e të cilat nuk janë kontestuese për palet ndergjyqese. Kontestuese mbetet çështja e pagesës së të ardhurave personale si dhe të ardhurave tjera si paga përcjellese për shkak të shkuarjes në pension.

Paditesi kërkesën e vet e mbështet në Kondratën Kolektive konkretisht në nenet 43 dhe 44.

Gjykata konsideron se në rastin konkret kërkespudina e paditeses në lidhje me pagat përcjellese për shkak të shkuarjes në pension është e PA BAZUAR për këto arsye:

Kontrata Kolektive në të cilën bazohet kërkesa e paditeses nuk është në fuqi që nga viti Janari I vitit 2008, pasi kohezigjatja e kësaj kontrate ka qenë për një periudhë 3 vjeçare. Ndërsa nga Vendimi për pushimin e marrëdhënies të punës për shkak të plotësimit të kushteve për pension të pleqërisë nr. dt. 30.04.2012, leshuar nga I vertetohet se paditsi është pensionuar me dt.20.12.2014.

Kjo specifikohet në nenin 90.4 të Ligjit të Punës, ku në mënyrë decisive thuhet: “Marreshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohezigjatje jo më shumë se tri (3) vjet”

Kontrata Kolektive ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2005, ndërsa që nga Janari I vitit 2008 sipas fuqisë ligjore e njëjta nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Ndërsa marreshja kolektive ka hyrë në fuqi me dt. 01.01.2015, ndërsa paditsi është pensionuar me dt 20.12.2014.

Andaj duke u bazuar ne te larte cekurat bazen ligjore te theksuar me larte dhe pretendimin e saj nga ana e gjykates , arrijme ne perfundim se kerkespadia e paditeses ne te refuzohet ne teresi si e PA BAZUAR.

Vendimin qe secila pale ti barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore, bazohet konform nenit 459.1 te LPK-se.

Nga te cekurat me larte e ne kuptim te nenit 143 te LPK-se u vendos si ne dispozitiv te ketije Aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.171/16, te dt.13.07.2017.

GJYQTARI,
Skender Shala

KESHILLE JURIDIKE :Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar anekesa, ne afat prej 7 ditesh, nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.